

## Raport Mujor për fondin Credins Pension

Fondi i Pensionit Privat Credins Pension synon optimizimin e kthimit nga investimi duke minimizuar riskun, me qëllimin për tu siguruar anëtarëve të Fondit të ardhura më të larta dhe të sigurt në moshën e pensionit. Portofoli i Fondit Credins Pension, do të përbëhet kryesisht nga obligacione afatgjata të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të denominuara në Lek, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.

Data e raportit: 31.03.2025

### Informacion për Fondin

Shoqëria Administruese e Fondit:	Credins Invest
Data e lançimit të fondit:	01 Janar 2012
Monedha e Fondit:	Lek

Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë një cilësi jete gjatë pensionit e cila nuk rezulton më e ulët sesa faza përpara daljes në pension.

### Profili i rrezikut dhe përfitimit

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të Republikës së Shqipërisë. Historikisht këto norma kanë treguar luhatshmëri të ulët.

Rrezik i ulët	Rrezik i lartë					
Përfitimet tipike më të ulëta	Përfitimet tipike më të larta					
1	2	3	4	5	6	7

Fondi Credins Pension ka një profil rreziku në nivelin 1, pra risku më i ulët.

### Të dhëna kryesore për Fondin

Vlera Neto e Aseteve	2,598,455,644.00
Çmimi i kuotës	1,777.6165
Numri i anëtarëve	19,260
Kthimi nga investimi (31.03.2024-31.03.2025)*	4.36%

\*Tarifa e administrimit është zbritur përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

### Karakteristikat e rrezikut të asetëve në Fond

#### Depozitat Bankare

Depozita Bankare si klasë asetë përmban rrezikun e kredisë së bankës dhe rrezikun e riçmimit në momentin e maturimit të saj.

Rreziku i riçmimit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtën maturitet.

#### Obligacionet dhe Bonot Qeveritare

Këto asetë janë të emetuara nga Qeveria, agjencitë apo ndërmarrje të sponsorizuara nga Qeveria. Megjithatë, qeveritë nuk garantojnë

pagesën e interesit apo principalit. Obligacionet apo Bonot qeveritare janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit dhe kanë nota krediti ("rating") të ndryshme. Bonot përmbajnë rrezik nga interesat më të lartë se obligacionet me të njëjtën kohë deri në maturim.

Në 21 mars 2025, Agjencia Ndërkombëtare "Standard & Poor's" përmirësoi vlerësimin për Shqipërinë në kategorinë 'BB' me perspektivë "të qëndrueshme", nga kategoria 'BB-' që ishte vlerësuar në mars 2024, e cila ishte përsëri përmirësim prej vlerësimit 'B+' që qëndronte prej shumë vitesh. Gjithashtu, Agjencia Ndërkombëtare e vlerësimit "Moody's" ka rishikuar vlerësimin e saj në datën 18 Tetor 2024, duke vlerësuar me rritje perspektivën e Shqipërisë nga "B1- me perspektivë pozitive" në "Ba3 - e qëndrueshme". Rritja e vlerësimit të kreditit për Shqipërinë, përmirëson riskun e kreditit të asetëve të Fondit, duke qenë se asetet e Fondit investohen në instrumentet financiare që emetohet nga shteti shqiptar.


### Kostot dhe Tarifat

Tarifa e Administrimit të Fondit mbahet nga asetet e Fondit. Tarifat që i ngarkohen Fondit çojnë në ulje të rritjes potenciale të investimit.

Pagesa e hyrjes	0%
Pagesa e daljes	0%
Pagesa vjetore	Tarifa e Administrimit 2% në vit e Vlerës Neto të Aseteve
Kosto transaksioni	0%
Tarifa e performancës	0%
Penalitetet në rast tërheqje të parakohëshme	Sipas Prospektit të Fondit 'Credins Pension'

### Shpërndarja e Instrumenteve si përqindje e Aseteve Totale

Shpërndarja e Instrumentave	ALL	%Aseteve
Obligacione	2,589,230,652.00	99.42%
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	14,981,032.34	0.58%




## Ankandet e titujve qeveritarë dhe normat e interesit

Qeveria e Republikës së Shqipërisë emeton letrat me vlerë në periudha relativisht të rregullta dhe të shpeshta. Në përputhje me materialet informuese të publikuara nga Ministria e Financave, ankandet e obligacioneve 2-vjeçare, 3-vjeçare dhe 5-vjeçare zhvillohen çdo muaj. Ankandet e obligacioneve 7-vjeçare dy herë çdo tre muaj, 10-vjeçare dhe 15-vjeçare një herë në tre muaj, dhe 20-vjeçare kryesisht çdo 3 muaj .


Ecuria e yield-eve të Obligacioneve

Ecuria e normave afatgjata



Gjatë muajit mars, u zhvillua ankandi për obligacionin 20-vjeçar, i cili rezultoi me normë 6.15% nga 6.78% që ishte në janar 2025. Gjatë muajit mars nuk u zhvilluan ankande për obligacionin 10-vjeçar dhe 15-vjeçar.

## Instrumentet e Portofolit sipas maturitetit të mbetur




## Kthimi vjetor neto historik

Kthimet neto të Fondit nga themelimi deri më 31 mars 2025 sipas periudhave të ndryshme janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Periudha e qendrimit	Kthimi vjetor i periudhës
1 vjeçare	4.36% në vit
2 vjeçare	4.28% në vit
3 vjeçare	4.06% në vit
4 vjeçare	3.85% në vit
5 vjeçare	3.65% në vit
Që nga themelimi	4.44% në vit

## Kthimi vjetor neto historik i 5 viteve të fundit



Asetet e Fondit Credins Pension do të investohen kryesisht në tituj afatgjatë 15 dhe 20 vjeçar të cilat kanë norma interesi më të larta.


Normat relativisht të larta të interesit të obligacioneve afatgjata kanë ndikim pozitiv për anëtarët e Fondit, pasi kontributet e tyre investohen me norma kthimi më të larta, gjë që rezultojnë në kthim më të lartë për Fondin në afat të gjatë.

## Ligji i ri ‘Për fondet e pensionit privat’

Në datë 6 Nëntor 2023 hyri në fuqi Ligji Nr. 76/2023 ‘Për fondet e pensionit privat’, i cili është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 21 shtator 2023. Ky zhvillim i ri ligjor mundëson përafrimin dhe harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit me direktivat europiane, si dhe sjell mjaft ndryshime pozitive në dobi të anëtarëve të fondit të pensionit krahasuar më ligjin paraardhës.

Duke konsideruar dhe hartimin e miratimin e akteve nënligjore nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare për zbatimin e këtij ligji, Shoqëria Credins Invest do të kryejë procesin e përshtatshmërisë së aktivitetit të saj dhe të Fondit ‘Credins Pension’ sipas kërkesave ligjore brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Për më shumë informacion rreth ndryshimeve kryesore të cilat afektojnë anëtarët e Fondit ‘Credins Pension’, jeni të ftuar të vizitoni faqen zyrtare të Shoqërisë [www.credinsinvest.com](http://www.credinsinvest.com)



*Performanca e kaluar është vetëm për qëllime ilustruese dhe nuk është një udhëzues, premtim apo garanci për performancën e ardhshme. Për informacion shtesë, jeni të ftuar të lexoni Prospektin e Fondit si dhe të vizitoni faqen zyrtare të shoqërisë [www.credinsinvest.com](http://www.credinsinvest.com)*